



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**GJYKATA KOMERCIALE**  
**PRIVREDNI SUD – COMMERCIAL COURT**

---

**GJ.A.nr.6241/24**  
**27.08.2024**

Bazuar në dispozitat e nenit 16 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr.08/L – 015, të datë 10 shkurt 2022, nenit 14 paragrafi 4 të Ligjit për Gjykata nr. 06/L – 054, të datë 18 dhjetor 2018, si dhe vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës - KGJK.nr.288/2021 të datë 18.10.2021, kryetari i Gjykatës Komerciale, më 27 gusht 2024, i propozon Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, për miratim:

**PROPOZIM**

**Për Plotësim/Ndryshimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024**

**PLOTËSOHET** Plani Vjetor i Punës së Gjykatës Komerciale për vitin 2024, ne pikat si në vijim:

- I. Ndryshohet Pika 5.2 e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, të Gjykatës Komerciale ashtu që Pika 5.2 përcaktohet si në vijim:

Në Gjykatën Komerciale janë të sistemuar shtatëmbëdhjetë (17) gjyqtarë, përkatësisht pesë (5) gjyqtarë në Dhomat e Shkallës së Dytë dhe dymbëdhjetë (12) gjyqtarë në Dhomat e Shkallës së Parë.

Secili departament do të ketë Udhëheqësin e Departamentit.

- Departamenti për Çështje Ekonomike – gjyqtarja Verona Dibra;
- Divizioni Lidhur me Kontestet me Investitorët e Huaj - gjyqtarja Verona Dibra
- Departamenti Fiskal – gjyqtari Fisnik Nuli;
- Departamenti për Çështje Administrative – gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi;
- Departamenti i Përgjithshëm – gjyqtari Alajdin Tërshnjaku;

II. Ndryshohet Pika 5.2.1 e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, të Gjykatës Komerciale ashtu që Pika 5.2.1 përcaktohet si në vijim

Gjyqtarët që do të gjykojnë në dhomat e shkallës së dytë janë:

- Faton Bajrami;
- Franciska Zhitija – Ymeri;
- Krenar Berisha;
- Dren Rogova; dhe
- Ramush Bardiqi.

Në Dhomat e shkallës së dytë kryetari i kolegjit dhe gjyqtarët/anëtarët përcaktohen në mënyrë automatike nga SMIL.

III. Ndryshohet Pika 5.2.2 e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, të Gjykatës Komerciale ashtu që Pika 5.2.2 përcaktohet si në vijim:

Të gjitha lëndët në Dhomat e Shkallës së Parë shqyrtohen dhe gjykohen nga gjyqtari individual.

Në Dhomat e Shkallës së Parë janë të angazhuar dymbëdhjetë (12) gjyqtarë, si vijon:

1. Alajdin Tërshnjaku
2. Verona Dibra
3. Hasan Kryeziu
4. Gent Bekeri
5. Arnis Dumani
6. Fisnik Nuli
7. Vlora Pacolli
8. Florent Zeqiri
9. Arbër Rexha
10. Vera Gashi Bela
11. Arben Toska
12. **Xhemajl Kurti**

IV. Ndryshohet Pika 5.2.2.1 e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, të Gjykatës Komerciale ashtu që Pika 5.2.2.1 përcaktohet si në vijim:

Në Departamentin për Çështje Ekonomike caktohen të punojnë gjashtë (6) gjyqtarë, si në vijim:

- Verona Dibra
- Arnis Dumani
- Hasan Kryeziu
- Arbër Rexha
- Florent Zeqiri
- **Arben Toska**

Gjyqtari Arben Toska i cili nga data 15 shtator 2024 kalon në Departamentin për Çështje Ekonomike do të mbetet i ngarkuar me lëndët të cilat janë në procedurë dhe do të punojë në këto lëndë administrative deri në përfundimin e tyre pavarësisht se në njëjtën kohë do të punojë edhe në lëndët ekonomike.

V. Ndryshohet Pika 5.2.2.2 e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, te Gjykatës Komerciale ashtu qe Pika 5.2.2.2 përcaktohet si në vijim:

Në Departamentin për Çështje Administrative caktohen të punojnë dy gjyqtarë si në vijim:

1. Vlora Pacolli Rexhepi dhe
2. **Gent Bekeri**

Gjyqtari Gent Bekeri i cili nga data 15 shtator 2024 kalon në Departamentin për Çështje Administrative do të mbetet i ngarkuar me lëndët të cilat janë në procedurë dhe do të punojë në këto lëndë me të cilat ka qenë i ngarkuar deri më tani, deri në përfundimin e tyre pavarësisht se në njëjtën kohë do të punojë edhe në lëndët administrative.

VI. Ndryshohet Pika 5.2.2.3 e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, të Gjykatës Komerciale ashtu që Pika 5.2.2.3 përcaktohet si në vijim:

Në Departamentin e Përgjithshëm caktohet të punojë një (1) gjyqtar – gjyqtari:

- Alajdin Tershnjaku:

Gjyqtari Alajdin Tershnjaku i cili nga data 15 shtator 2024 kalon në Departamentin e Përgjithshëm do të mbetet i ngarkuar me lëndët të cilat janë në procedurë dhe do të punojë në këto lëndë

ekonomike deri në përfundimin e tyre pavarësisht se në të njëjtën kohë do të punojë edhe në lëndët e Departamentit të Përgjithshëm.

Për shkak të numrit të vogël të lëndëve, gjyqtari i caktuar në këtë Departament, përveç lëndëve që bien në kompetencë të këtij Departamenti do të vazhdojë të punojë edhe me lëndët përmbare, në proporcion me lëndët që iu ndahen gjyqtarëve tjerë të Departamentit për Çështje Ekonomike.

VII. Ndryshohet Pika 5.2.2.4 e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, të Gjykatës Komerciale ashtu që Pika 5.2.2.4 përcaktohet si në vijim:

Në Departamentin Fiskal caktohen të punojnë tre (3) gjyqtar si në vijim:

- Fisnik Nuli
- Vera Gashi Bala dhe
- **Xhemajl Kurti**

Gjyqtarit Xhemajl Kurti do t'i ndahen lëndët në proporcion me gjyqtarët tjerët të Departamentit Fiskal. I njëjti Gjatë periudhës së “Trajnimit Praktik për gjyqtarët e sapoemëruar” do të punojë nën monitorimin e mentorëve përkatës dhe gjatë kësaj periudhë nuk do të ngarkohet me lëndë të natyrës urgjente përfshirë kërkesat për shtyrje të ekzekutimit.

VIII. Ndryshohet Pika 5.3.6 e Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, te Gjykatës Komerciale ashtu që Pika 5.3.6 përcaktohet si në Vijim:

Për përcjelljen dhe unifikimin e praktikës gjyqësore në Dhomat e Shkallës së Dytë do të kujdeset gjyqtari Dren Rogova;

Për përcjelljen dhe unifikimin e praktikës gjyqësore në dhomat e shkallës së parë:

- Departamenti për Çështje Ekonomike - gjyqtarja Verona Dibra
- Departamenti Fiskal – gjyqtari Fisnik Nuli
- Departamenti për Çështje Administrative – gjyqtarja **Vlora Pacolli Rexhepi**
- Departamenti i Përgjithshëm – gjyqtari **Alajdin Tershnjaku**.

- IX. Te gjitha pikat e këtij Plotësim/Ndryshimi të Planit të punës, pas miratimit nga KGJK, mbisundojnë çdo përcaktim në Planin Vjetor të Punës për vitin 2024, të Gjykatës Komerciale dhe çdo përcaktim nga Plani Vjetor i Punës të Gjykatës Komerciale për vitin 2024, i cili bie ndesh me këtë Plotësim/Ndryshim, shfuqizohet apo interpretohet/lexohet sipas përcaktimeve në këtë Plotësim/Ndryshim.


### **A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me Vendimin KGJK.nr.290/2024, dt.30 korrik 2024, ka marrë vendim më të cilin e ka propozuar gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për lirim nga detyra e gjyqtares për shkak të përfundimit të mandatit me dorëheqje.

Po ashtu me Vendimin e KGJK-së, nr.482/2023, dt.27.11.2023, Xhemajl Kurti, është propozuar që të emërohet gjyqtar me mandat fillestar në Gjykatën Komerciale-Dhomat e SHK.I. ndërsa është dekretuar nga Presidentja e Kosovës me datë 16.01.2024. I njëjti nga data 02.09.2024, do të fillojë punën si gjyqtar në Gjykatën Komerciale -Dhomat e SHK.I.

Për shkak të ndryshimeve të sipër cekura në përbërjen e gjykatës si dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë Kryetari i Gjykatës Komerciale bazuar në Rregulloren Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës si dhe performancën aktuale të gjykatës, propozon ndryshimin e Planit Vjetor i Punës të Gjykatës Komerciale për vitin 2024, i cili përfshin edhe riorganizimin e Dhomave të Shkallës së Dytë dhe Dhomave të Shkallës së parë të Gjykatës Komerciale, sipas propozimeve në këtë Plotësim/Ndryshim të Planit Vjetor të Punës për vitin 2024.

Pjesa tjetër e planit të punës së Gjykatës Komerciale, mbetet e pandryshuar.

**Mahir TUTULI**  
  
**Kryetar i Gjykatës Komerciale**